

EPS

F - GF

dekoll®

PREMIX PER L'EDILIZIA



"Izolimi i së
nesërmes,
ndërtuar sot
me sistemet
EPS të Dekoll"

Pesha e lehtë. Performancë e lartë.

Ideale për fasada dhe ambiente të brendshme,
siguron efikasitet termik, rezistencë dhe jetëgjatësi.
Zgjedhja profesionale për ndërtim modern.

PREMIX PER L'EDILIZIA



01

Sistemi kapot është padyshim sistemi më efektiv dhe më ekonomik i kursimit të energjisë.

Produktet përbërëse të sistemit kapot dhe karakteristikat:

1. Ngjitesi i polisterolit
2. Panelet termoizoluese EPS F , EPS GF
3. Upa
4. Rrjeta perforcuese me fibra qelqi
5. Kendore dhe pikore te perforcuara me rrjete
6. Rrafshuesi sistemit kapot
7. Astari i Grafiatos
8. Grafiato (veshje dekorative perfundimtare)

• Sistemi kapot përdoret si veshje e jashtme e fasadave të reja , te vjetra ose të rinovuara me qëllim përmirësimin e performancës termike të mureve.

• Percjellshmeria termike përta i përket termoizolimit EPS F, EPS GF duhet të ketë karakteristikën që të mos lejojë rrymat termike të kalojnë lehtësisht në mure . Transferimi i nxehtësisë nga brenda - jashtë në dimër dhe anasjelltas në verë, kufizohet ndjeshëm nëse përcjellshmëria termike e polisterolit është e ulët.

• EPS F 80 , 100 , 120 , 150 , 200 dhe EPS GF 100 , 120 , 150 kanë vlerat e tyre të përcjellshmërisë. Sa më i ulët të jetë koeficienti lambda), aq më efektiv është materiali izolues .

Koeficienti I percjellshmerise termike ndikohet gjithashtu dhe nga dendesia e polisterolit ,sa me I dendur te jete polisteroli aq me I ulet eshte koeficienti I percjellshmerise termike .

•Rezistenca ndaj nxehtësisë .Trashësia e materialit dhe dendesia gjithashtu luan një rol të rëndësishëm: sa më i trashë të jetë polisteroli , aq më e madhe është rezistenca termike (R)

termax®
S A L V A E N E R G I A

02

Avantazhet e EPS F dhe EPS GF në SISTEM KAPOT.

Sistemi i izolimit të jashtëm, duke përmirësuar izolimin termik të mureve, garanton avantazhet e mëposhtme:

Rritja e efikasitetit energjetik

- Redukton humbjet e nxehtësisë në dimër dhe ndihmon në freskinë e ambientit në verë.
- Ndhmon në uljen e faturave të energjisë elektrike dhe ngrohjes.

Izolim më i mirë termik dhe akustik

- Përmirëson ndjeshëm izolimin termik të ndërtesës.
- Redukton ndjeshëm zhurmat që vijnë nga jashtë.

Mbrojtje e murit dhe strukturës

- Mbron fasadën nga faktorët atmosferikë si shi, dëborë, diell apo ngrica.
- Zgjat jetën e strukturës së murit dhe parandalon çarjet dhe plasaritjet për shkak të ndryshimeve të temperaturës.

Parandalon formimin e lagështirës ,mykut dhe kondensim

- Lagështia ose avujt e ujit mund të lëvizin, brenda ose jashtë një ndërtese, në dy mënyra:
 1. Nëpërmjet rrymave të ajrit (ajrosje natyrale ose ventilim mekanik) 98%
 2. Nga difuzioni nëpër materiale (përshekueshmëria)
- Duke e vendosur izolimin nga jashtë, shmanget kondensimi brenda murit, gjë që ndihmon në shmangien e lagështirës dhe mykut në brendësi.

Estetikë dhe personalizim

- Jep një pamje moderne dhe uniforme fasadës së ndërtesës.
- Lejon përdorimin e ngjyrave dhe materialeve të ndryshme për dekorim sipas dëshirës.

Përputhshmëri me standardet evropiane


- Sistemi KAPOT është në përputhje me direktivat dhe standardet e BE-së për kursimin e energjisë dhe performancën termike të ndërtesave.

Eliminimi i urave termike

- Këto janë zona në një ndërtesë ku kalimi i nxehtësisë është më i lartë se në pjesët e tjera të strukturës, siç psh janë struktura metalike, elemente betoni brenda muratues. Urat termike mund të shkaktojnë humbje të energjisë, si dhe mund të çojnë në kondensim dhe formimin e mykut. Kjo ndodh sepse këto zona lejojnë kalimin e nxehtësisë nga jashtë në brendësi të ndërtesës, ose anasjelltas,

Rrit vlerën e pronës

- Një ndërtesë e izoluar mirë dhe me fasadë estetike ka më shumë vlerë tregu.



03.





Panelet termoizoluese EPS F, EPS GF

Panelet termoizoluese EPS F, EPS GF janë panel izolues i perbere nga polistireni i zgjeruar me permbajtje polistireni dhe grafiti, me strukturë me qeliza të mbyllura, vetëshuarës I klasës E, i shënuar me ETICS sipas standardit EN 13163.

Respekton gjithashtu CAM – Kriteret Minimale Mjedisore, përmes përdorimit të EPS të ricikluar pas konsumit. I përshtatshëm për ndërtesa të reja dhe të vjetra, si në sipërfaqe vertikale dhe horizontale.

Karakteristikat:

- **Qëndrueshmëri në formë gjatë luhatjeve atmosferike.**
- **Dendësi homogjene.**
- **Veti Hidrofobike.**
- **Izolues akustike.**
- **Rezistencë të lartë në shtypje.**
- **Përcjellshmëri shumë të ulët termike**



03.01

Llojet e polisterolit te sistemit
kapot me te dhenat teknike:
TDS të produkteve tona me specifikat e tyre

SKEDË TEKNIKE

PRODUKTI : EPS F80

TË DHËNAT TEKNIKE

NORMATIVAT

Përcaktimi:	Panel Termoizolues EPS F80	
Ngjyra:	E bardhë	EN 13163
Ambalazhi:	Polietilen	
Njësia matëse:	m ³	
Standarti:	EN 13163	
Përmbajtja e kokrrizës:	Gaz Pentan	
Dimensioni i panelit:	1000mm x 500mm	EN 823:2013
Sipërfaqja e pllakës:	0.5m ²	EN 822
Pesha:	13-14.5 kg/m ³	
Forca në shtypje:	80 kPa	EN 826
Spesori i Panelit:	50 mm, 100 mm	
Koeficienti i percjellshmerise termike (λ):	0.037 W/mK	EN 12667
Koha e stazhionimit:	28 dite nga data e prodhimi	
Reaksioni ndaj zjarrit:	Klasa E (I vetshuajshëm)	EN 13501-1:2019

SKEDË TEKNIKE

PRODUKTI : EPS F100

TË DHËNAT TEKNIKE

NORMATIVAT

Përcaktimi:	Panel Termoizolues EPS F100	
Ngjyra:	E bardhë	EN 13163
Ambalazhi:	Polietilen	
Njësia matëse:	m ³	
Standarti:	EN 13163	
Përmbajtja e kokrrizës:	Gaz Pentan	
Dimensioni i panelit:	1000mm x 500mm	EN 823:2013
Sipërfaqja e pllakës:	0.5m ²	EN 822
Forca në shtypje:	113.3 kPa	EN 826
Koeficienti i percjellshmerise termike (λ):	0.03511 W/mK	EN 12667
Koha e stazhionimit:	28 dite nga data e prodhimi	
Reaksioni ndaj zjarrit:	Klasa E (I vetshuajshëm)	EN 13501-1:2019
Spesori i panelit:	50 mm, 100 mm	
Rezistenca termale:	1.395 m ² *K/W	EN 12667
Forca në prerje tërthore:	225.4	EN 1607
Forca në përkulje:	231.1	EN 12089
Toleranca në gjerësi W:	± 2mm	EN 822
Toleranca në gjatësi L:	± 2mm	EN 822
Toleranca e spesorit T:	1mm	EN 823
Toleranca e sipërfaqes S:	± 2mm	EN 824
Forca prerëse:	100 kPa	EN 12090:2013
Moduli i forcës prerëse:	1798 kPa	EN 12090:2013

PRODUKTI : EPS F120

TË DHËNAT TEKNIKE

NORMATIVAT

Përcaktimi:	Panel Termoizolues EPS	
Ngjyra:	E bardhë	EN 13163
Ambalazhi:	Polietilen	
Njësia matëse:	kg/m ³	
Standarti:	EN 13163	
Përmbajtja e kokrrizës:	Gaz Pentan	
Dimensioni i panelit:	1000mm x 500mm	EN 823:2013
Sipërfaqja e pllakës:	0.5m ²	EN 822
Forca në shtypje:	141.4 kPa	EN 826
Pesha:	17-18.5 kg/m ³	
Koeficienti i percjellshmerise termike (λ):	0.03463 W/mK	EN 12667
Rezistenca termale:	2.899 m ² *K/W	EN 12667
Forca ne prerje terthore:	268.25 kPa	EN 1607
Forca ne Perkulje:	305.5 kPa	EN 12089
Absorbimi I ujit:	0.07 kg/m ²	EN 16535
Koha e stazhionimit:	28 dite nga data e prodhimi	
Reaksioni ndaj zjarrit:	Klasa E (I vetshuajshëm)	EN 13501-1:2019
Toleranca në gjerësi W:	± 2mm	EN 822
Toleranca ne gjatësi L:	± 2mm	EN 822
Toleranca e spesorit T:	1mm	EN 823
Toleranca e sipërfaqes S:	± 2mm	EN 824
Forca prerëse:	105 kPa	EN 12090:2013
Moduli i forcës prerëse:	2614 kPa	EN 12090:2013

PRODUKTI : EPS F150

TË DHËNAT TEKNIKE

NORMATIVAT

Përcaktimi:	Panel Termoizolues EPS F150	
Ngjyra:	E bardhë	EN 13163
Ambalazhi:	Polietilen	
Njësia matëse:	m ³	
Standarti:	EN 13163	
Përmbajtja e kokrrizës:	Gaz Pentan	
Dimensioni i panelit:	1000mm x 500mm	EN 823:2013
Sipërfaqja e pllakës:	0.5m ²	EN 822
Forca në shtypje:	151.2 kPa	EN 826
Rezistenca termale:	2.878 m ² K/W	EN 12667
Koeficienti i percjellshmerise termike (λ):	0.034 W/mK	EN 12667
Koha e stazhionimit:	28 dite nga data e prodhimi	
Reaksioni ndaj zjarrit:	Klasa E (I vetshuajshëm)	EN 13501-1:2019
Forca në prerje tërthore:	250.55 kPa	EN 1607
Forca në përkulje:	336.9 kPa	EN 12089
Absorbimi i ujit:	0.07 kg/ m ²	EN 16535
Spesori i panelit:	50 mm, 100 mm	
Toleranca në gjerësi W:	± 2mm	EN 822
Toleranca ne gjatësi L:	± 2mm	EN 822
Toleranca e spesorit T:	1mm	EN 823
Toleranca e sipërfaqes S:	± 2mm	EN 824
Forca prerëse:	138 kPa	EN 12090:2013
Moduli i forcës prerëse:	2274 kPa	EN 12090:2013

PRODUKTI : EPS F200

TË DHËNAT TEKNIKE

NORMATIVAT

Përcaktimi:	Panel Termoizolues EPS F200	
Ngjyra:	E bardhë	EN 13163
Ambalazhi:	Polietilen	
Njësia matëse:	kg/m ³	
Standarti:	EN 13163	
Përmbajtja e kokrrizës:	Gaz Pentan	
Dimensioni i panelit:	1000mm x 500mm	EN 823:2013
Sipërfaqja e pllakës:	0.5m ²	EN 822
Forca në shtypje:	(10% deformim) 200 kPa	EN 826
Koeficienti i percjellshmerise termike (λ):	0.032 W/mK	EN 12667
Koha e stazhionimit:	28 dite nga data e prodhimi	
Reaksioni ndaj zjarrit:	Klasa E (I vetshuajshëm)	EN 13501-1:2019

PRODUKTI : EPS GF100

TË DHËNAT TEKNIKE

NORMATIVAT

Përcaktimi:	Panel Termoizolues EPS GF 100 (GRAFIT)	
Ngjyra:	E zezë	EN 13163
Ambalazhi:	Polietilen	
Njësia matëse:	m ³	
Standarti:	EN 13163	
Përmbajtja e kokrrizës:	Gaz Pentan	
Dimensioni i panelit:	1000mm x 500mm	EN 823:2013
Sipërfaqja e pllakës:	0.5m ²	EN 822
Toleranca në gjerësi W:	± 2mm	EN 822
Toleranca në gjatësi L:	± 2mm	EN 822
Toleranca e spesorit T:	1mm	EN 823
Toleranca e sipërfaqes S:	± 2mm	EN 824
Forca në shtypje:	103.1 kPa	EN 826
Koeficienti i percjellshmerise termike (λ):	0.03156 W/mK / 0.03146 W/mK	EN 12667
Koha e stazhionimit:	28 dite nga data e prodhimi	
Reaksioni ndaj zjarrit:	Klasa E (I vetshuajshëm)	EN 13501-1:2019
Spesori i panelit:	500 mm x 1000mm x 50mm / 140 mm	
Rezistenca termale:	1.603 m ² *K/W / 4.396 m ² *K/W	EN 12667
Forca në prerje tërthore:	193.7 kPa	EN 1607
Forca në përkulje:	215.1 kPa	EN 12089
Absorbimi i ujit:	0.12 kg/m ²	EN 16535
Forca prerëse:	92 kPa	EN 12090:2013
Moduli i forcës prerëse:	2014 kPa	EN 12090:2013

PRODUKTI : EPS GF120

TË DHËNAT TEKNIKE

NORMATIVAT

Përcaktimi:	Panel Termoizolues EPS GF 120 (GRAFIT)	
Ngjyra:	E zezë	EN 13163
Ambalazhi:	Polietilen	
Njësia matëse:	m ³	
Standarti:	EN 13163	
Përmbajtja e kokrrizës:	Gaz Pentan	
Dimensioni i panelit:	1000mm x 500mm	EN 823:2013
Sipërfaqja e pllakës:	0.5m ²	EN 822
Forca në shtypje:	123 kPa	EN 826
Koeficienti i percjellshmerise termike (λ):	0.0299 W/mK	EN 12667
Koha e stazhionimit:	28 dite nga data e prodhimi	
Reaksioni ndaj zjarrit:	Klasa E (I vetshuajshëm)	EN 13501-1:2019
Spesori i panelit:	500 mm x 1000mm x 50mm	
Rezistenca termale:	1.669 m ² K/W	EN 12667
Toleranca në gjerësi W:	± 2mm	EN 822
Toleranca ne gjatësi L:	± 2mm	EN 822
Toleranca e spesorit T:	1mm	EN 823
Toleranca e sipërfaqes S:	± 2mm	EN 824

PRODUKTI : EPS GF150

TË DHËNAT TEKNIKE

NORMATIVAT

Përcaktimi:	Panel Termoizolues EPS GF 150 (GRAFIT)	
Ngjyra:	E zezë	EN 13163
Ambalazhi:	Polietilen	
Njësia matëse:	kg/m ³	
Standarti:	EN 13163	
Përmbajtja e kokrrizës:	Gaz Pentan	
Dimensioni i panelit:	1000mm x 500mm	EN 823:2013
Sipërfaqja e pllakës:	0.5m ²	EN 822
Forca në shtypje:	(10% deformim) 150 kPa (10 t/m ²)	EN 826
Koeficienti i percjellshmerise termike (λ):	0.0298 W/mK	EN 12667
Koha e stazhionimit:	28 dite nga data e prodhimi	
Reaksioni ndaj zjarrit:	Klasa E (I vetshuajshëm)	EN 13501-1:2019
Toleranca në gjerësi W:	± 2mm	EN 822
Toleranca ne gjatësi L:	± 2mm	EN 822
Toleranca e spesorit T:	1mm	EN 823
Toleranca e sipërfaqes S:	± 2mm	EN 824

04

Ngjitja e EPS F dhe EPS GF.

Një guidë e përgjithshme për fazat e instalimit EPS F dhe EPS GF.

Përpara se të fillohet ngjitja e polistrolit në suport duhet të sigurohemi për aftësinë mbajtëse dhe rezistencën e suportit ku aplikohet EPS. Në rast se suporti nuk jep garanci për rezistencë të mjaftueshme sipërfaqësore, është e nevojshme që të bëhet rregullimi i sipërfaqes.

- Në rastin e një murature jo të niveluar me defekte, duhet bërë nivelimi i sipërfaqes me llac (për disnivele me të > 5 mm të rrafshohen me llaç të përshtatshëm)
- Në rastin e disniveleve deri në 1 cm të bëhet rregullimi i sipërfaqes me rrafshuesin e sistemit kapot me forcë shtypëse të lartë (Bondex)
- Suvatë dhe veshjet që nuk janë mjaftueshëm rezistente duhet të hiqen dhe të ribëhen nga e para
- Plasaritjet dhe çarjet në muraturë duhet të mbyllen pasi ato rrezikojnë funksionalitetin e izolimit


Aplikimi i ngjitesit :

Aplikoni produktin me mallë mbi pllakën izoluese në një trashësi prej 30 mm duke zënë rreth 45% të pllakes me ngjites me metoden me topa dhe shirita. Përpara nivelimit të sipërfaqes me kollë vendosni kunjat fiksuese në varësi të pllakës së vendosur 5-6 kunjat/m².

Foto ilustruese për ngjitjen e sistemit kapot



Mënyra e duhur për të vendosur panelin izolues



04.01

Gabime gjatë ngjitjes së polisterolit

Çfarë nuk duhet të ndodhi gjatë ngjitjes së polisterolit



Gjatë fazës së punimeve , temperatura e ambientit dhe e sipërfaqes nuk duhet të bjerë nën +5°C dhe nuk duhet të kalojë 35°C . Gjatë gjithë kohëzgjatjes së punës për ngjitjen e EPS F dhe EPS GF , rrafshimit dhe deri në përfundimin e fazës së vendosjes së upave , sipërfaqja duhet të mbrohet me pëlhura të përshtatshme që ofrojnë hije. Mbroni panelet izolues nga lagështia dhe aplikoni në kohën e duhur shtresën rrafshuese me rrjete.

05

Upat fiksuese

Perse duhet ti perdorim upat fiksuese?

Panelet izoluese ne pergjithesi kerkojne gjithmone upa fiksuese pervec ngjitjes në suport. Për sistemet kapot ku aplikohet I gjithë sistemi I plote dhe ka nje peshe te caktuar relativisht te larte (ngjitës + EPS + veshje perfundimtare), per polistrol me force shtypese me te madhe se 80 Mpa dhe me te gjere se 5 cm eshte e domosdoshem montimi i upave.





06

Këndore, Pikore dhe Rrjetë përforcuese.

Perse duhet ti perdorim patjetër këndoret dhe pikoret

Për një rezultat të mirë funksional, praktik, estetik dhe afatgjatë të sistemit kapot , është e nevojshme të garantohet , krahas aplikimit te produkteve duke u azuar ne skedat teknike , edhe edhe perdorimi i aksesoreve te tjere shtese si kendore pikore , rrjete perforcuese.



07

Rrjeta përforcuese me fibra qelqi

Për rrafshim

Rrjeta përforcuese me fibra qelqi aplikohet në mënyrë të tillë që të zhytet në rrafshuesin e polisterolit. Në kënde apo në vëndet e bashkimit në dyer apo dritare është e nevojshme që të aplikohet dy herë rrjeta përforcuese. Temperaturat optimale të punimit janë nga 5° C deri në 35° C. Për veshjet e mëvonshme është e rëndësishme që bazamenti të ketë arritur maturimin në tharje rreth 5-7 ditë kjo varet nga kushtet atmosferike.



Kujdes!!!

Gjatë fazës së transportit dhe montimit, tregoni kujdes maksimal dhe punoni në kushte të sigurta. Gjatë fazave të punës, temperatura e ambientit përreth dhe e sipërfaqes nuk duhet të jetë më e ulët se $+5^{\circ}\text{C}$ dhe më e lartë se $+35^{\circ}\text{C}$. Respektoni udhëzimet aktuale të prodhuesit dhe të dhënat e fletës së sigurisë. Produkti është i destinuar për përdorim profesional. Mos përzieni apo shtoni elementë të tjerë gjatë përgatitjes dhe aplikimit. Çdo ndryshim në udhëzimet e mësipërme duhet të autorizohet shprehimisht nga shërbimi përmes një miratimi të shkruar dhe të nënshkruar.

Gjatë punimit dhe ngurtësimit/tharjes, temperatura e ajrit, materialit dhe sipërfaqes duhet të qëndrojë midis $+5^{\circ}\text{C}$ dhe $+35^{\circ}\text{C}$. Mbroni fasadën nga rrezatimi i drejtpërdrejtë i diellit, shiu dhe era e fortë (p.sh. duke përdorur rrjeta mbrojtëse për skelat). Edhe temperaturat e larta (p.sh. $> +35^{\circ}\text{C}$) mund të ndryshojnë karakteristikat e punimit të produktit. Lagështia e lartë relative dhe/ose temperaturat e ulëta (p.sh. aplikimet në dimer) mund të zgjasin dukshëm kohën e tharjes dhe të shkaktojnë ndryshime të pabarabarta të ngjyrës. Mbroni panelet izolues nga lagështia dhe aplikoni sa më shpejt një shtresë mbulimi; panelet që kanë ndryshim në ngjyrë dhe/ose të demtuar duhet të zëvendësohen.

Uniformiteti i ngjyrës garantohet vetëm duke përdorur produkte nga i njëjti grup prodhimi dhe me të njëjtën datë prodhimi. Ndryshimet e rëndësishme të ngjyrës mund të ndodhin gjithashtu për shkak të karakteristikave të ndryshme të sipërfaqes, të aplikimit dhe për shkak të temperaturës dhe lagështisë atmosferike. Materialet e ruajtura përtej kufirit të kohës së përcaktuar mund të kenë ndryshime ngjyrash. Nuk pranohen ankesa për ndryshime të ngjyrës dhe/ose karakteristikave pas aplikimit. Të dhënat teknike i referohen produkteve bazë. Përdorimi i lëndëve të para natyrore mund të sjellë ndryshime të lehta në vlerat e caktuara dhe ato mund të ndryshojnë në varësi të kushteve të kantierit. Produkti nuk duhet të ekspozohet për një periudhë të gjatë ndaj kushteve të këqija të motit, duhet të magazinohet në ambiente të pershatshme.

Më shumë detaje në lidhje me sigurinë janë të përfshira gjithashtu në fletët tona të veçanta të të dhënave të sigurisë. Këto fletë duhet të lexohen me kujdes para përdorimit. Respektoni udhëzimet aktuale kombëtare të punës. Kjo fletë teknike anullon dhe zëvendëson versionet e mëparshme. DEKOLL rezervon të drejtën për të bërë ndryshime dhe përditësime edhe pa njoftim paraprak. Informacioni i përfshirë në këtë fletë teknike pasqyron njohuritë dhe përvojat tona aktuale teknike të sektorit; ato nuk përcaktojnë në asnjë rast përgjegjësinë e kompanisë DEKOLL për ndonjë defekt dhe/ose dëm të çdo lloji që rrjedhin nga përdorimi i papërshtatshëm ose i parregullt i produktit.

Pas maturimit të të gjitha hapave , vazhdohet me veshjen dekorative duke iu permbajtur të dhënave teknike në skemat e produktit.



dekoll[®]

PREMIX PER L'EDILIZIA

termax[®]
S A L V A E N E R G I A

Dëshironi të dinimë shumë mbi produktet tona ?

Autostrada Tiranë - Durrës, Km 5.



www.dekoll.al



+355 69 606 6656



info@dekoll.al